



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2019:218882

Datë: 12.03.2025

Numri i dokumentit: 06979090

C.nr.3304/2019

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari Florian Krasniqi, në çështjen juridike të paditësit B.S. nga Prishtina, të cilin e përfaqëson B.A. avokat në Prishtinë, ndaj të paditurës K.S.“D” me seli në Prishtinë, me objekt kontesti kompensim dëmi, pas përfundimit të shqyrtimit kryesor publik, me datë 12.03.2025, mori këtë:

A K T G J Y K I M

- I. **APROVOHET** në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditësit B.S. dhe **DETYROHET** e paditura K.S. “D.”, që paditësit në emër të kompensimit të dëmit material për automjet (veturë), të shkaktuar në aksidentin e datës 09.07.2019, t’ia paguaj shumën prej 450 €, me kamatë ligjore prej 8% në vit, e cila do të filloj të llogaritet nga dita e parashtrimit të padisë datë 02.10.2019 e deri në pagesën definitive, të gjitha në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënimin e përmbarimit të detyrueshëm.
- II. **DETYROHET** e paditura që paditësit t’ia kompensojë shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej 554.00 €, në afat prej 15 dite nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të detyrueshëm.

A r s y e t i m

Paditësi B.S. me datë 02.10.2019, përmes të autorizuarit të tij, pranë kësaj gjykate ka paraqitur padi ndaj të paditurës K.S. “D.”, për kompensimin e dëmit.

Në padi ka pretenduar se me datë 09.07.2019, në fshatin Bresje, Komuna Fushë Kosovë, është shkaktuar aksident trafiku në mes të K.P. – drejtues i automjetit të markës “ VW Golf”, pa targa dhe Berat Sejdiut – drejtues i automjetit “BMW” me targë Tutje ka theksuar se deri të aksidenti i trafikut ka ardhur me fajin ekskluziv të vozitësit K.P., i cili nuk e ka mbajtur distancën e mjaftueshme në mes të automjeteve, me ç ‘rast e godet automjetin e tipit BMW me drejtues B.S. Me parashtrësën e datës 06.02.2025, për precizimin e kërkesëpadisë si dhe në seancat e shqyrtimit gjyqësor dhe në fjalën përfundimtare, i njëjti ka kërkuar që të aprovet

kërkesëpadia si e bazuar, ashtu që duke marrë për bazë vlerësimin e dëmit nga eksperti i makinerisë Q.A., ka kërkuar nga e paditura që paditësit në emër të kompensimit të dëmit material për automjetin (veturë), t'i paguaj shumën prej 450 euro, me kamatë ligjore duke filluar prej ditës së ushtrimit të kërkesëpadiës për kompensim dëmi me datë 27.09.2019, me kamatë prej 8% deri në pagesën definitive si dhe shpenzimet e procedurës 104 euro për padi, për një (2) seanca të mbajtura shumën 270.40 euro, për ekspertizë të makinerisë shumën 150 euro, si dhe për taksë gjyqësore shumën 31 euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm.

E paditura përmes përgjigjes në padi ka deklaruar se nuk e konteston bazën juridike të kërkesëpadiës mirëpo vetëm lartësinë e saj, duke theksuar se në bazë të procesverbalit mbi evidentimin e dëmit të përpiluar nga inxhinieri i kompanisë dhe vetë palës, konkludojnë se shuma e cila është ofruar është e arsyeshme për riparim të veturës, në të kundërt të gjitha palët të cilët konsiderojnë se këto mjete janë të pamjaftueshme për rregullim të veturës, këta si kompani i ofrojnë edhe rregullimin në auto serviset e kontraktuara nga ana e tyre, njoftim ky i cili u jepet verbalisht secilës palë që nga momenti i paraqitjes së dëmit, andaj edhe shuma e ofruar është e arsyeshme për rregullim të veturës. I ka propozuar gjykatës që padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit ta refuzojë si të pabazuar. Në seanca gjyqësore dhe në fjalë përfundimtare, përfaqësuesi i të paditurës ka deklaruar se nuk e konteston bazën juridike të kërkesëpadiës, mirëpo ka kërkuar nga gjykata që gjatë marrjes së vendimit të nxjerrë aktgjykim ku aprovohet pjesërisht kërkesëpadia e paditësit, ashtu që shumën prej 450 euro ta gjykoj me kamatë nga dita e nxjerrës së aktgjykimit, ndërsa të refuzohen në tërësi shpenzimet procedurale për shkak se këto shpenzime janë krijuar me fajin e vetë paditësit.

Për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike dhe fakteve vendimtare, gjykata gjatë shqyrtimit kryesor ka bërë administrimin dhe vlerësimin e provave si në vijim: raporti policor me nr.2019-DR-0216, i datës 09.07.2019, polisa e sigurimit kufitar e datës 08.07.2019, librezja e automjetit e datës 06.02.2019, ekspertiza e makinerisë, dhjetor 2024.

Gjykata pas vlerësimit të pohimeve të palëve ndërgjyqësve dhe provave të nxjerra në kuptim të nenit 8 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK), me kujdes dhe me ndërgjegje ka çmuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha ato së bashku, dhe ka gjetur se kërkesëpadia e paditësit është në tërësi e bazuar.

Në këtë çështje juridike kontestimore nuk ishte kontestues fakti se automjeti (vetura) e drejtuar nga paditësi në aksidentin e komunikacionit të datës 09.07.2019, ka pësuar dëm material. Po ashtu nga e paditura nuk është kontestuar as baza juridike e kërkesëpadiës, gjegjësisht nuk ishte kontestues fakti se aksidenti nga i cili dëme kishte pësuar automjeti (vetura) e paditësit ishte shkaktuar me fajin e të siguarit të të paditurës. Po ashtu për gjykatën nuk ishte kontestuese as lidhja kauzale në mes të shkakut dhe pasojës, si kusht thelbësor për ekzistimin e përgjegjësisë për dëmin e shkaktuar, kjo për faktin se nga e paditura nuk është kontestuar fakti se automjeti (vetura) e paditësit kishte pësuar dëme në aksidentin e datës 09.07.2019.

Kontestuese në mes të palëve ndërgjyqëse ishte lartësia e kërkesëpadiës, gjegjësisht shumat e

kompensimit të dëmit material, që i takojnë paditësit si pasojë e dëmeve të automjetit (veturës) pësuar nga aksidenti.

Meqenëse siç u theksua më lartë, përgjatë zhvillimit të procedurës gjyqësore nuk ka qenë kontestuese baza juridike e kërkesëpadisë, pra nga e paditura nuk është kontestuar fakti se automjeti (vetura) e paditësit ka pësuar dëme si pasojë e aksidentit në komunikacion, andaj gjykata vlerëson se ka lindur e drejta e paditësit për të kërkuar kompensimin e dëmit material nga e paditura, kjo siç është përcaktuar me dispozitën e nenit 136 paragrafi 1 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve e cila dispozitë përcakton se: *“Kush i shkakton tjetrit dëm ka për detyrë ta kompensojë, përveç nëse vërtetohet se dëmi është shkaktuar pa fajin e tij”*.

Për vërtetimin e lartësisë së kërkesëpadisë, me propozimin e palës paditëse Gjykata ka bërë nxjerrën e provës me ekspertizë nga lëmia e makinerisë, e hartuar dhe punuar nga eksperti Q.A.. Eksperti në bazë të fotografive të automjetit të dëmtuar dhe procesverbalit mbi dëmin material ka dhënë mendimin profesional dhe ka konstatuar se në automjetin BMW 520d, me targa, është shkaktuar dëm material në pjesën e pasme. Sipas vlerësimit të të njëjtit për riparimin dhe kthimin e automjetit në gjendjen e mëparshme, janë të nevojshme puna e dorës dhe materiali shpenzues, që përbëjnë në total vlerën e përgjithshme të shpenzimeve prej 450 euro.

Gjykata ia fali besimin në tërësi ekspertizës së ekspertit ngase vlerësoi se mendimi i tij është dhënë mbi bazën e dokumentacioneve dhe fotografive pjesë e shkresave të lëndës dhe parimeve profesionale të punës. Po ashtu, të gjeturat e ekspertizës nuk janë kontestuar nga palët ndërgjyqëse.

Bazuar në gjetjen e ekspertit gjykata ka caktuar edhe shumën e kompensimit si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Andaj, duke u bazuar në dispozitat e lartcekura, gjykata mbi bazën e vlerësimit të të gjitha kritereve dhe masave për caktimin e lartësisë së shpërblimit të dëmit material, posaçërisht duke marrë parasysh natyrën dhe shkallën e dëmtimit të automjetit (veturës) dhe vlerësimit të ekspertizës së makinerisë, aprovoi tërësisht kërkesëpadinë e paditësit si të bazuar, duke gjykuar vlerën e shpërblimit të dëmit si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Lidhur me kërkesën për kamatën ligjore, Gjykata vendosi në kuptim të nenit 382 paragrafi 1 lidhur me paragrafi 2 të LDM-së, duke llogaritur rrjedhën e kamatës nga dita e parashtrimit të padisë në gjykatë 02.10.2019, e deri në përmbushjen definitive të detyrimit. Gjykata ka caktuar për dëmin material datën e rrjedhjes së kamatës ligjore prej 8% vjetore, duke filluar nga dita e parashtrimit të padisë në gjykatë, duke u bazuar edhe në Mendimin Juridik për Kamatën të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës GJ.A.Su.A.265/2020, dt.02.12.2020, ku në pjesën e tretë të këtij mendimi, gjegjësisht pikën XIV, përcaktohet: *“Pavarësisht kur është lindur marrëdhënia e detyrimeve, për kërkesat që i referohen dëmit material (dëmi material dhe fitimi i munguar), kamata fillon të rrjedhë nga data e parashtrimit të kërkesës së kreditorit për kompensimin (e pranuar nga debitori) dhe në rast të mos parashtrimit të kërkesës nga ana e kreditorit për kompensim, atëherë kamata fillon të rrjedh nga data e parashtrimit të padisë e deri në pagesën e plotë”*.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës është marrë në bazë të nenit 452.1 të LPK-së. Në rastin konkret shpenzimet e krijuara gjyqësore si detyrim i të paditurit, i referohen shumës së vendosur si në pikën II të dispozitivit të aktgjykimit, e cila përfshin: për padi shumën prej 104€, për përfaqësim në dy seanca nga 135€, gjithsejtë për seanca shumën prej 270€, për ekspertizë të makinerisë shumën prej 150 €, për taksën gjyqësore për padi 30 €, të gjitha në shumë prej 554 €.

Andaj, bazuar në të lartcekurat dhe duke ju referuar nenit 143 të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore (LPK), gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
C.nr.3304/2019 me datë 12.03.2025

Gjyqtari
Florian Krasniqi

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 dite, nga dita e pranimit të të njëjtit, në Gjykatën e Apelit në Prishtinë nëpërmes kësaj gjykate.